

UNIVERSITETI I GJAKOVËS

FAKULTETI I FILOLOGJISË

Dega e Gjuhës Shqipe



PUNIM DIPLOME

Tema: “Lumi i vdekur”i Jakov Xoxës ,*analizë*

Mentori:

Prof.ass.dr.Besim Muhadri

Kandidatja:

Arlinda Nuza

Gjakovë, 2019

DEKLARATA

Unë Arlinda Nuza studente e Fakultetit Filologjik Dega Gjuhë Shqipe në Gjakovë deklaroj se kjo temë diplome është punim origjinal. E gjithë literatura dhe burimet e tjera që i kam shfrytëzuar gjatë punimit janë plotësisht të cituara.

Në rradhë të parë falenderoj familjen time. Nuk do t'ia kisha dal mbanë pa mbështetjen, inkurajimin dhe dashurinë tuaj të pafund! Ndiej nevojën për të falenderuar profesorët e Fakultetit Filologjik, në mënyrë të veçantë të programit të Gjuhës Shqipe, të cilët me punë dhe pasion përcollën tek unë njohuritë e nevojshme për tu formuar intelektualisht! Falenderoj mentorin tim, Besim Muhadrin, për ndihmën e vazhdueshme si dhe kolegët të cilët më mbështëten miqësisht në tri vitet e mia të studimit. Kam patur kënaqësinë dhe fatin të këshillohesha me një profesor të tillë të cilin e falënderoj për sugjerimet që më dha gjatë punës sime për përgatitjen e kësaj teme! Të fundit por jo më pak të rëndësishëm, falënderoj ata që mi mësuat vlerat e miqësisë dhe dashurisë së pakusht. Kjo është për ju! Ju faleminderit që më mësuat të besoj në veten time dhe në ëndërrat e mia!

Përmbajtja

DEKLARATA	2
Hyrje	4
Jeta dhe vepra e Jakov Xoxws	5
Analiza e romanit Lumi i Vdekur	7
Ndërtimi i personazhëve të Lumi i vdekur	10
Vita ,femër anticipuese në romanin Lumi Vdekur	11
Bukuria e Vitës	14
Vita dhe kosovari	15
Paraqitja.....	18
Lumi i vdekur ,monumenti gjuhësor i shqipes	19
PËRFUNDIMI.....	23
Bibliografia	24
Literatura.....	24

Hyrje

Periudha e realizmit në letërsinë shqipe,edhe pse nuk u zhvillua në kohën dhe binarët e letërsive të popujve të tjerë,megjithatë me disa shkrimtarë dhe vepra të veçanta arriti kulmet krijuese.Realizmi socialist që rivalizoi realizmin e mërfilltë,me githë dëmet që i solli letërsisë shqipe,nuk arriti ta shuaj në tërësi atë. Ndër veprat më të njohura të kësaj periudhe,padyshim është romani *Lumi i vdekur* i shkrimtarit Jakov Xoxa,në të cilin shfaqet jeta e rëndë e fshtatarësisë shqiptare në fund të viteve '30,më saktësisht në prag të Luftës së Dytë Botërore.

Mjeshtëria krijuese me të cilën Jakov Xoxa e realizoi veprën e tij,mbetet një nga më të rrallat në letërsinë shqipe.Përveç tematikës së zgjedhur,mënyrës së ndërtimit të fabulës përmes gërshetimit të linjave fabulare,ndërtimit të personazhëve si pjesmarrës aktiv në ngjarje,kohëzisionit të fuqishëm të të gjitha shtresave të romanit,një vlerë të veçantë ka edhe gjuha e pasur që ai e përdorë.Të gjitha këto elemente të ndërlidhura me kujdes me njëra-tjetrën i siguruan një sukses të jashtëzakonshëm romanit *Lumi i vdekur* dhe shkrimtarit Jakov Xoxa.Kjo vepër,për një kohë të shkurtër u bë vepër shumë popullore,e afërt për lexuesin shqiptar,ndërsa personazhet e saj zunë vendet më të rëndësishme në letrat shqipe.

Në këtë punim, do të bëjmë përpjekje që të analizojmë rradhazi disa nga segmentet më të rëndësishme të romanit *Lumi i vdekur*,sepse për t'i analizuar në mënyrë të detajuar,do të duhej një hapësirë shumë më e gjerë.Duke i trajtuar problematikat thelbësore që kanë të bëjnë me veprën në fjalë,synojmë që të nxjerrim në pah vlerat artistike dhe mjeshtërinë krijuese të Jakov Xoxës,gjithnjë duke u mbështetur edhe në analizat që studiuesit e tjerë kanë bërë për të.Mirpo,para se të merremi me veprën *Lumi i vdekur*,fillimisht do të ndalemi te informacionet mbi veprimtarinë krijuese të Jakov Xoxës.

Jeta dhe vepra e Jakov Xoxës

Jakov Xoxa (1923-1979) lindi në qytetin e Fierit. Që i ri mori pjesë në Luftën Antifashiste. Pas Qilirimit të vendit vazhdoi studimet e larta për Filologji dhe njëkohësisht bëri edhe hapat e para në poezi e në prozë.

Më 1949 botoi veprën e parë në prozë *Novela*. Krijimtarinë letrare në këtë zhanër e vazhdoi edhe gjatë viteve '50, kështu në vitin 1958 botoi veprën e dytë, po me të njëjtin titull *Novela*. Ndërkohë botoi edhe dy drama *Buqet Osumi dhe Zemra*. Që nga viti 1957 punoi profesor në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë në Universitetin e Tiranës, ku për shumë vite ligjëroi lëndën Teoria e letërsisë. Për nevojat e studentëve, në formën e dispensës, botoi në katër vëllime veprën *Bazat e teorisë së letërsisë*, që ishte nga veprat më serioze të kohës. Pikërisht se në të autori ofronte dije dhe përvojë teorike letrare të gjerë, që dilte jashtë kornizave të teorive zyrtare të kohës, kjo vepër e rëndësishme për shkencën letrare shqiptare, nuk u botua kurrë. Autori i saj u qortua dhe ai pa bujë e zhurmë, ashtu siç ishte gjatë tërë jetës, i qetë, i mbyllur në vete, u tërhoq në vetmi.¹

Pjesën më të madhe të jetës krijuese e kaloi në fshatrat myzeqare afër Fierit, ku në vetmi të plotë krijoi romanet: *Lumi i vdekur* (1965), *Juga e bardhë* (1971) *Lulja e kripës* (1978), që hyjnë në rrethin e romaneve artistikisht më cilësorë, të letërsisë shqiptare.

Asnjë roman para tij nuk e pasqyron në mënyrë aq komplekse botën shqipëtare në prag të Luftës së Dytë Botërore, si *Lumi i vdekur* apo dhe periudhën gjatë luftës, që përfshin romani *Lulja e kripës* dhe periudhën pas çlirimit të vendit, të *Juga e bardhë*.

¹ Grupautorësh, Letërsia bashkëkohore shqipe 4, Tiranë, 2001

Këto romane ,janë tri nga pesë romanet e projektit krijues i njohur si iksi romanesk,ku Xoxa mendoj të përfshinte edhe dy romane të tjera:*Dielli lind nga malet* dhe *Ari i zi*,pjesë të të cilave i la në dorëshkrim,por nuk arriti t'i përfundonte.

Jakov Xoxa është nga romancierët më me zë të gjysmës së shekullit XX.Në krijimtarinë e tij letrare ai individualizohet me parimin krijues realist:fati individual do të jetë ai që do të hedhë dritë mbi kontestin tërësor të mjedisit dhe të kohës së fokusuar në rrëfime.Shëmbëllyeshëm me romanet e shquara realiste të shkrimtarëve më me zë të letërsisë botërore,Jakov Xoxa do ta vendosë dramën jetësore të personazhëve dhe të familjeve në sfond të një kolektiviteti,të një gjendjeje apo të një rrjedhe historike.

Nga titujt e veprave që botoi:

- Novela(1949)
- Buçet Osumi(1957)
- Lumi i vdekur-roman(1965)
- Juga e bardhë-roman(1971)
- Lulja e kripës-(botuar pas vdekjes në dy vëllime,1980/81)²

Lumi i vdekur,është njëri ndër romanet më të mira të Letërsisë Shqipe,të një periudhe të caktuar letrare,periudhës së realizmit.Personazhët,qofshin ato pozitivë apo negativë,mbajnë haptazi qëndrimet e tyre përkatëse e sidomos personazhet antagoniste fshatar-çifligar.Mirpo,në interesin tonë këtë radhë është paraqitja e dashurisë,lindja e saj mes të rinjve,kuroëzimi i saj,të cilat me plot mjeshtri i paraqet shkrimtari Jakov Xoxa.

² Po aty,fq.210

Analiza e romanit Lumi i Vdekur

Ngjarjet shtrihen brenda viteve 1938 -1939 të shekullit XX. Rrëfimi i ngjarjes në romanin "*Lumi i vdekur*" fillon me shpërnguljen e dhunshme të familjes së Pilo Shpiragut nga fshati Grizë dhe mbyllet pas një viti, me shpërnguljen po të kësaj familjeje, tani nga fshati Trokth. Brenda këtij harku kohor janë vendosur një varg ngjarjesh, kryesisht dramatike, me intensitet shkallëzues. Qerrja e ngarkuar me plaçkat e shtëpisë nis rrugën pa ditur ku do të degdiset.

Sa për një natë Pilo Shpiragu vendos të strehohet tek hani i Bishtanakës, ku rastësisht ai do të gjejë "shpëtim" te tregtarët e Fierit, të cilët do ta punësojnë në fermën e fshatit Trokth. Në të njëjtën kohë ai do të njihet dhe me familjen kosovare të Sulejman Tafilajt..

Pakti mes Pilo Shpiragut dhe tregtarëve të Fierit nuk do të arrijë ta mbushë as rrethin kohor të një viti. Përmbytja simbolike e fshatit nga lumi i përçudnuar solli pasoja tragjike për Shpiragajt, të cilëve dhe ç'ka u mbeti nga gjëja e gjallë do t'ua rrëmbejnë përsëri tregtarët.

Kështu, familja Shpiragaj mbeti në mes të rrugës më e vetmuar dhe më pa asgjë se kurrë më parë. Ballë për ballë me rrezikun për të mbetur pa ekzistencë, që të mbijetojë, Pilo Shpiragu vendos t'i bindet përsëri beut dhe të pranojë kërkesat e tij që si viktimë të parë lakmonte Vitën, ai vendos ta punësojë atë kopile në oborrin e beut.

Bota e fshatit të Myzeqesë,pra,shtrihet brenda projektit të gjerë përmes fatit të tri familjeve:të familjes Shpiragu,të dëbuar nga beu i vendit,të asaj kosovare Tafilaj,të dëbuar nga pushtuesi sllav dhe të familjes trokthase të Koz Dynjasë.

E para do sprovohet përmes kthesave më të mprehta dramatike,ajo e Kosovës do të sfidohet nga shija dhe ndjenja e ardhacakut,e të huajit,prandaj e nënshtruar do të provojë të përshtatet me kushtet e reja,si dhe familjet e fshatit Trokth,të vendosura në luftë të përhershme për t'u mbrojtur dhe për të siguruar egzistencën. Paralelisht me këto rrjedha dhe e gërshetuar me to do të zhvillohet edhe lidhja intime mes vashës së Shpiragajve,Vitës dhe kosovarit Adil. Kjo linjë nga ana e vet ka shijen dhe domëthënien e një simbolike.

Shpleksja e arracionit të romanit do të nisë me arratisjen e Vitës dhe të Adilit në male.

Figura e Pilo Shpiragut është strumbullar që i lidh tërë rrjedhat narrative të romanit. Ky përcaktim kompozicional i autorit ka rezultuar që ,edhe pse bëhet fjalë për një nga romanet më voluminoze të letërsisë shqiptare,rrjedhat fabulare të tij lidhen përmes një kohezioni të qëndrueshëm,të brendshëm. Edhe atëherë kur rrëfihen “mesele”nga urtia dhe përvoja jetësore e popullit,ato qoftë drejtpërdrejtë apo tërthorazi,lidhen dhe kanë të bëjnë me shtratin bosht të ngjarjes së rrëfyer.

Pilo Shpiragu është figurë tek i cili është përqendruar vëmendja e autorit. Dhe,ai,Pilo Shpiragu,është nisur të jetë i përkryer si njeri,që ta ruajë deri në fund pastërtinë,për ligjet e jetës mbi të kanë rënë me tërë brutalitetin dhe në çaste të caktuara e kanë detyruar të lakohet.

Megjithatë,Pilo Shpiragun e përjetojmë si figurë që rrezaton domethënie përgjithësuese,si një person që shpreh dhe një pjesë të sprovave e të dilemave të kohës së vet.³Natyre enegjike dhe me iniciativë,Pilo Shpiragu beson se do të arrijë pavarësinë ekonomike të familjes,falë krahëve dhe djersës së vet,duke mos e ndjerë nevojën për solidaritet.

Por ky ishte një iluzion.Pilo Shpiragu këte do ta mësojë më vonë.

³ Jakov Xoxa,1,2,3,Tiranë,1965,101

E dëbuar dhunshëm nga pushtuesi serb,ajo nuk do të rehatohet në moçalet malarike të Myzeqesë dhe nuk do ta gjejë ngrohtësinë e mjedisit.

Fati i familjes së arratisue dhe të dëbuar kosovare do të vazhdojë dhe në epokën e komunizmit shqiptar.Jakov Xoxa i ka vërejtur me mbrehtësinë e intuitës krijuese raportet mes fshatarëve të Myzeqesë dhe të Kosovës që në fillim e kanë përjetuar si kundërshtar njëri-tjetrit,si palë që do ta rrezikonte apo vështirësonte egzistencën e secilit.

Një parim tjetër në praktikën krijuese të Jakov Xoxës është edhe synimi për të rrëfyer bindshëm.Ai që rrëfen,pra tregimtari në emër të autorit,dëshiron ta bindë lexuesin në atë shkallë vërtetësie që nuk është e mundur pa qenë njëherë i bindur vetë,rrëfyesi. Ky parim tregimtar e kultivon praktikisht sqarimin,arsyetimin,mbështetjen absolute të çdo detaji dhe të çdo veprimi.

Një dimendson që romanin e Jakov Xoxës e bën tërheqës,është ndjenja se tërësinë e fabulës e rrëfen një dëshmitar i vërtetë i ngjarjeve dhe se ky tregimtar thotë të vërtetën,di të zgjedhë fjalë e shprehje të vërteta,t'i shqiptojë qetë ato,të nxisë kërshërinë për të dëgjuar e për të ditur “ç’ndodhi më vonë”:të zgjojë interesim për personazhët.

Tek romani *Lumi i vdekur*,⁴krahas rrjedhave spontane të veprimeve të personazhëve,qoftë të përcaktuara ato nga shtysat e jashtme ose të brendshme,ndjehet ndërhyrja e autorit,sado e fshehtë qoftë.

⁴ Po aty,220

Ndërtimi i personazhëve te *Lumi i vdekur*

Një nga segmented më të rëndësishme të romanit *Lumi i vdekur*, është edhe mënyra e ndërtimit të personazhëve dhe shumëllojshmëria e tyre. Jakov Xoxa përmes tyre ka përfaqësuar të gjitha shtresat e popullatës së Myzeqesë, duke i pajisur ata me të gjitha tiparet karakteristike të grupit, apo shtresës që përfaqësojnë. Aty gjejmë fshatarin e varfër pa asnjë pëllëmbë tokë si Pilo Shpiragu e të tjerë, gjejmë fshtarin e varfër por kryengritës, që nuk pajtohet me shtypjen dhe shfrytëzimin (Koz Dynjaja), gratë fshatare të përkushtuara ndaj familjes dhe shtëpisë, të rinjtë që edhe pse jetojnë në një botë të varfër, përsëri gjejnë mënyra për t'i dhënë kuptim jetës së tyre, gjejmë edhe fshatarin e pasur, beun, që jeton në kurriz të të tjerëve dhe synim i tij është shfrytëzimi, pastaj kosovarët e ikur nga toka e vet nën dhunën e pushtuesit, tregtarët, klerikët e shumë të tjerë, që së bashku e krijojnë tablonë e jetës reale në Myzeqe. Si të tilla këto personazhe jo vetëm që krijojnë një botë të veçantë, por edhe kanë bindjet e tyre filozofike, psikologjike, religjioze e sociale.

Realizimi në shkallë të lartë i botës së brendshme dhe të jashtme, kërkon një vëmendje të veçantë, sepse është nga më të veçantit në letërsinë shqipe.

Vita ,femër anticipuese në romanin Lumi i Vdekur

Ne si lexues bazik gjatë leximit të këtij romani përjetojmë emocione të ndryshme si:

Egzistencën e individit përballë sprovave të jetës,ku përshkruhen gjerësisht dhe me hollësi lindja dhe vdekja,dashuria dhe urrejtja ,gëzimi familjar dhe miqësor,fatkeqësia dhe hidhërimi,miqësia,mëria dhe armiqësia.Asnjë roman para këtij nuk e pasqyron në mënyrë aq komplekse botën shqiptare në prag të Luftës së Dytë Botërore se sa *Lumi i Vdekur*,ku gjejmë një shtrije të pakufishme të rrëfimit që mbulon plotësisht hapësirën e jetës dhe të egzistencës së mjedisit shqiptar.

Lexuesi,qysh në momentet e para të leximit takohet me këto familje,anëtarët e të cilave përballen me kushte të vështira egzistencialiste,pra me dëbimin dhe largimin e këtyre familjeve. Familja e parë do të sprovohet me kthesa të mëdha dramatike.Ajo e Kosovës do të sfidohet nga shija dhe ndjenja e ardhacakut,e të huajit,prandaj ishte nënshtruar që t'u përshtatet kushteve të reja të jetës.Ndërsa familja e fshatit Trokth ishte në luftë të përhershme për mbrojtjen e dinjitetit njerëzor dhe për të siguruar egzistencën e jetës.

Paralelisht me këto rrjedha dhe në zhvillimin e këtyre ngjarjeve do të ndodhë dhe do të zhvillohet një lidhje intime mes Vitës,vajzës së Pilo Shpiragut dhe Adilit,djalit Kosovar të Sulejman Tafilit.Kjo lidhje do të ketë më vonë edhe anën e saj simbolike.

Vërshimet e mëdha që ndodhën në fshat,nga ringjallja e *Lumit të vdekur*,pastaj prishja e marrëveshjes nga ana e tregtarëve,e bënë Pilon që të mbetej pa asgjë,dhe i mbetur në mes të rrugës,pa strehë dhe pa mbrojtje të familjes,ai detyrohet t'i bindet urdhrave të beut të fshatit i cili ia kishte vënë syrin Vitës së bukur.

Personazhi i Vitës ,për lexuesin është një tërësi ndjenjash,prandaj gati receptohet nëpërmjet ndjenjave të saj si një heroinë sentimentale.Ajo më tepër përjeton dashurinë sesa jeton me mundimet dhe vuajtjet e përditshme.

Vita ka hovin,dëshirën dhe intuitën që duke ndjekur zërin e zemrës së saj të ndryshoj jo vetëm fatin e vet,por duke thyer tabutë t'i hapë rrugë edhe ndryshimit progresiv të fatit të femrës shqiptare në përgjithsi.

Vita,në shikim të parë duket se bie viktimë e gjendjes së rëndë familjare,atë babai e detyron që të punësohet në oborrin e beut dhe në njëfarë mënyre e sakrifikon atë.Por ky akt i Pilos i mundëson Vitës që të bëjë hapin vendimtar në jetë,bashkimin me të dashurin e saj dhe shkeljen e zakoneve të prapambetura.Megjithatë,veprimi i Pilos,duket veprim i babait që nuk brengoset për fatin e së bijës,shkrimtari i jep atij një kuptim tjetër ,më të plotë. Pilo Shpiragu i katandisur si mos më keq nga vuajtjet e familjes së tij,duke bredhur sa në një vend në tjetrin duke synuar minimumin e rehatisë familjare,i ndodhur nën presionin e fuqishëm të gjendjes pa rrugëdalje,detyrohet të ndërmarrë një hap që edhe vet e urrente. Vetëm me një fragment të shkurtër të romanit,mund të shihet mundimi që përjeton Piloja me familje,shihen çastet që tregojnë shpërnguljen e familjes Shpiragu dhe dhimbjet e lindjes që e kanë shtrëngur gruan e Pilos,Rinën.Ajo përpëlitet në qerren që lëviz rrugës me gropa nëpër fushën e Myzeqesë.

-E gjithë rruga që përshkon karvanin ka një domethënie simbolike.

-Varfëria,rruga me baltë,qerret me qetë e lodhura,karrocat e mbushura me njerëz dhe dengje leckash,është pra rruga e jetës së familjeve Myzeqare në vitet e 30-ta.Në qerren e Pilo Shpiragut përveq leckave qëndrojnë edhe :plaka me urimet dhe mallkimet e saj,Piloja me zemërimin dhe përgjegjësinë e prijësit të karvanit,Kili i vogël që dremitë nga lëkundjet e qerres,Vita në prag të shpërthimit të vajzërisë dhe gruaja shtatzënë me rënkimet dhe dhimbjet e saj.

Ngjarje dramatike dhe tronditëse do të ndodhin në rrjedhën e ngjarjeve në roman kur Vita dhe Adili vendosin të ikin në mal.Ata tash veç ishin të dashuruar,prandaj edhe kishin forcën të bënin këtë sakrificë sublime.Sakrifica për dashurinë plotësohet më pas edhe nga një arsye tjetër,jeta që ata kaluan në male i bën që më vonë ata të kthehen fitimtarë në Myzeqenë e shumëvuahtur.

Në këtë mënyrë vjen në spikamë roli anticipues e emancipues i Vitës, vajzës s bukur myzeqare e cila kishte vendosur të lidhë fatin e vet jetësor me një Kosovar, e ai është Adili ,i biri i Sulejman Tafilit.

Është kjo një simbolik tepër domethënëse, sa njerëzore sa kombëtare, por në veqanti edhe shumë artistike. Roli i vqantë i Vitës si një vajzë e pjekur dhe e formuar edhe për nga mosha s'kishte më shumë se 16 vjet, hetohet edhe në interesimin e saj gjatë udhëtimit të kësaj familje me qerre nëpër rrugët e Myzeqesë. Kur të gjithë anëtarët qëndronin në qerren e dytë, të mbuluar e të heshtur, ajo kërcen nga qerrja, për të vrapuar shpejt te qerrja e parë ,aty ku qëndronte nëna e saj, shtatzënë dhe e sëmurë. Ja një fragment i shkurtër:

Nga bishti i qerres së pasme kërcen në rrugë dhe nga drejt së parës një vajzë nja gjashtëmbëdhjetë vjeçe. Pa ngjëruar asgjëkund, i ra baltës përmes dhe doli në krye të karvanit.

Ishte Vita, çupa e madhe e Pilos.⁵

-Ç'kërkon, moj bijë, që erdhe!...i foli gjyshja. Nuk bënë të rrish këtu, po shko...je çupë e rritur tash ti...

-Nënë, ç'ka nëna?!!

Vita kishte vërejtur se nëna ishte në gjendje të rëndë shëndetësore, prandaj edhe kishte vrapuar te ajo, ani pse kishte kush të kujdesej për të. Ajo largohet vetëm me ndërhyrjen e Pilos.

Të gjitha këto segmente Jakov Xoxa i shprehë përmes rrëfimit të qetë, me përfytyrime dhe asociacione të pasura, botën e pasur të personazhëve, në veqanti botën e brendshme dhe veprimet e jashtme të saj.

⁵ Jakov Xoxa, Lumi i vdekur, Tiranë, 94

Bukuria e Vitës

Aftësia e Xoxës për të skalitur personazhët, bie në sy veçanërisht te personazhi i Vitës, me tiparet e brendshme dhe të jashtme të saj. Ajo shfaqet si një vajzë shumë e bukur, që edhe pse ende shumë e re në moshë, tiparet tërheqëse kishin shpërthyer fuqishëm në shtatin e saj, të zhvilluar shumë më tepër sesa i takonte moshës që kishte. Këmbët i kishte të gjata (siç thotë shkrimtari: *Ja tani, atje, në buzë të qerres, kërcinjtë e saj të varura jashtë sa nuk mërrinin në dhe*), i dukeshin akoma më të gjata nën fustanin e vjetër, shkurtuar shumë, ngase ishte rritur shumë brenda këtij viti të fundit. Pastaj, thithkat e gjinjëve të vegjël, si ai bisku i fasules që ngrenë kokën e fryn tokën e ardhur nga ngrohtësia e pranverës, ia kishin hedh krahërorin e përhedhur, duke vënë në pah shkathiësinë e saj fizike. Kështu e përshkruan poeti bukurinë e jashtme të Vitës, për të vazhduar më tej me shpalosjen e botës së brendshme të saj. Vita ishte vajza më e madhe në familjen e Pilos. Si vajza më e rritur që ishte, në mes të atyre djemve në moshë, ajo e ndjente një lloj ndrojtje, turpi për ato shenjat e para të femrës që me ditë po i piqeshin e me orë po i shquheshin.

Prandaj ajo nisi një nga një t'ia fshehë botës:

Në fillim, nën qepallat e gjata si halë gruri mbuloi sytë lavaresh, pastaj zgjati fustanin nja dy gisht për të fshehur kufijtë e kofshëve dhe më vonë kur pa se s'po ia dilte me të ndrydhur e shtrydhur të gjoksit që po shpërthente pa e pyetur atë, përkuli kurrizin përpara me mundim për një farë kohe, t'i bëjë ballë sulmit të moshës së bukur, po të paturpshme. Gjithë djemtë e Grizës shkallonin pas asaj qupe.⁶

Duke fshehur kështu Vita bukurinë e saj, ajo nuk e dinte se po e rriste edhe më shumë kureshtjen e djemve të fshatit. Por deri atëherë asnjë s'ia kishte ngritur dot sytë dhe shtatin: siç duket qerpikët e Vitës kishin qëlluar shumë të rëndë... Por deri kur Vita do ta fshihte krahërorin?...

⁶ Agim Vinca, Teorialetrare, Prishtinë, 2013, fq. 58

Ky fragment është vlerësuar lart nga kritika shqipe. Përshkrimi i bukurisë së Vitës nga shkrimtari Jakov Xoxa, është një nga kurorat më të bukura që i rri mbi romanin *Lumi i vdekur*, por edhe një nga perlat e prozës shqiptare. Bukuria fizike dhe varfëria duket se nuk kanë asnjë lidhje në mes veti. Bukuria e Vitës lidhet me pjesën më të bukur të vajzërisë, me virgjinitetin dhe pastërtinë e botës shqiptare, me turpin e natyrshëm, por edhe të vetëdijshtëm të kësaj vajze fshati. Drita e bardhë e dashurisë nuk pyet për errësirën e fatit nënvizon në fund shkrimtari, Megjithatë lexuesi parandien te Vita si çastet e ëmbla dhe ato të hidhurat.

Vita dhe kosovari

Ndryshimi i Vitës nga paraqitja fillestare në roman bëhet shpejt, me t'u takuar familja myzeqare me familjen kosovare te Hani i Bishtanakes. Takimi mes dy familjeve ngërthen në vete takimin mes dy të rinjëve. Vita tanimë e dashuruar në Adilin, nuk donte të dinte më as për beun, nga i cili vareshin familja, as qëndrimin e familjes së saj, që e vështrojnë Adilin si me një urrejtje, ngase edhe këta e kishin hetuar dashurinë e tyre. E gjithë kjo hetohet dhe bie në sy kur Vita me vëllezërit dhe kushëritë e saj kishin hyrë në arën e kosovarit për të korrur grurin. Në sytë e Vitës tashti, jo vetëm Adili që ishte më i bukur i fshatit, por edhe gruri i kosovarëve dallonte nga gruri i Myzeqesë. Shfaqet kështu një zgjerim i kufijve të dashurisë njerëzore edhe në objektet përreth. Kur shkon në arë për të korrur, Vita e kishte mendjen te Adili, ajo dëshironte shumë atë ditë që së paku për së largu ta shihte Adilin.

Ndjenja e padurimit për t'u takuar me të dashurin, kishte bërë që të vëreheshin ndërrime edhe në pamjen e jashtme të trupit të saj.

Ja se si e përshkruan shkrimtari këtë gjendje të Vitës në një fragment:

“Tani edhe ajo përkulja pakëz përpara,të cilën Vita e pati zanat nga koha kur fshihte me drojë nishanet e vajzërisë,thua jse qe zhdukur fare dhe tani trupi i qëndronte drejt dhe i zhdërvjellur.Tani dashuria sikur i kishte dhënë të drejtë të zbulojë bukurinë e saj”.⁷

Gjatë leximit takohemi me bukurinë dhe thjeshtësinë e Vitës që del si nëpër legjendat tona.Kështu Vita duket taman sikur një zanë mali,apo si Tanusha,bukurinë e së cilës e përshkruan Halili,i vëllau i Gjeto Basho Mujit.

Prania e Vitës në roman ndihet e fortë,kurse bëmat dhe sjelljet shihen më pak.Zgjimi i ndjenjave dashurore shkon krahas zhvillimit femëror dhe zbukurimit të saj,aq sa duket sikur dashuria e zhvillon dhe e zbukuron atë.Përshkrimet për zgjimin e saj dashuror dhe zhvillimin femëror janë ndër më emocionueset dhe të rralla në prozën shqipe. Edhe marrëdhëniet e saj me të tjerët,kryesisht,janë marrëdhënie ndjenjash.Si bijë,vuan dhembjen e madhe për vdekjen e parakohshme të së ëmës,si motër provon herët dhembshurinë për të vëllanë dhe motrën e vogël jetime;si vajzë e sinqertë dhe pa paragjykime përjeton thellë dashurinë erotike për Adilin.

Vita,gjithashtu,është simboli i pasioneve rinore të vrullshme dhe të dilemave të pandalshme,është simnoli i dashurisë që çel edhe në kënetën e jetës,edhe në mes të fanatizmit,simbol i gëzimit dhe i përsëritjes së jetës;simbol i femrës që ngacmon erotikisht njerëzit dhe poetizon krejt mjedisin,kurse Pilo Shpiragu është figurë tek i cili është përqendruar vëmendja e autorit.

Autori në tiparet e tij bën që të koncentrohen paragjykimet dhe morali i fshatarëve shqiptarë të kohës;përmes tyre ai arrin të realizojë tipizimin letrar për rrethanat e mjedisit shqiptar të asaj kohe.

⁷ Po aty,fq.68-70

Gjatë leximit të këtij romani ,lexuesi veç konflikteve tjera,ndeshet edhe me konfliktet e Vitës me rrethin shoqëror dhe me familjen e saj.Ndaj Vitës,gratë e fshatit,me fanatizmin e tyre,xhelozinë dhe thashethemet,krijojnë një armiqësi.Armiqësia e tyre i cenon nderin dhe i rrezikon dashurinë,përveç konfliktit me gratë e fshatit kemi edhe kundërshtimin e Ferhat Tafilit,xhaxhait të Adilit,i cili nuk e jep pëlqimin për ta marrë Vitën nuse,sepse sjelljet e saj të lira janë jashtë normave zakonore.Pengesë tjetër kemi edhe vëllanë e Vitës,Llazin,i cili është në kundërshtim me dashurinë e Vitës me Adilin për shkak të fanatizmit,sedrës dhe paragjytimeve krahinore ndaj kosovarëve të ardhur,prandaj bën çmos që ta ndalojë dhe ta prishë këtë dashuri.Konfliktin tjetër e kemi mes Vitës dhe të atit Pilos,i cili përpiqet me mbikqyrjen e rreptë ta mbajë brenda normave zakonore,kurse e bija nuk i përfillë fare ato norma,përkundër kërcënimeve nga i ati.

Dashuria e Vitës me Adilin arrihet kur kapërcehen krejt këto pengesa,pasi tejkalohen tërë këto konflikte,të shumtën e rasteve jo me zgjidhje të papritura e të veçanta,por me injorim të tyre.Kështu,keta dy personazhë te lexuesit ngjallin emocione nga më të ndryshmet.Ata gjatë gjithë rrjedhës së romanit krijojnë emocione të një shkalle të lartë,ku në këtë roman bëhet ndeshja e personazheve me natyrën,me dukuritë e verba të saj,me traditën dhe me mentalitetin,të cilat ua vështirsojnë edhe jetën.

Ne si lexues,nga Jakov Xoxa mund të nxjerrim si mësim se njeriu është në ndeshje të përhershme me natyrën,përderisa nuk e zotëron atë,ndërsa është në mirëkuptim kur arrin ta nënshtrojë atë.Natyra,toka,moti,lumi,deti,këneta,pylli,etj,ashtu siç janë burim jete dhe të mirash lëndore,ashtu janë edhe burim mundimesh dhe fatkeqësish njerëzore.Ngjarrjet në roman zhvillohen mbi ngjalljen dhe vërshimin e *Lumit të vdekur*,që ringjallet dhe vërshon rrallë,një herë në çdo brez,prandaj edhe quhet *Lumi i vdekur*.Në roman vërshimi i tij simbolizon forcat e verbra të natyrës të pa zotëruar nga njeriu.

Një parim tjetër krijues te Jakov Xoxa është edhe synimi për të rrëfyer bindshëm,pra shkrimtari dëshiron që ta bind lexuesin në atë shkallë vërtetësie që nuk është e mundur pa qenë njëherë i bindur vetë,ai që rrëfen.

Një dimension që romanin e Jakov Xoxës e bën tërheqës,është ndjenja që tërësinë e fabulës e rrëfen një dëshmitar i vërtetë i ngjarjeve dhe se ky tregim thotë të vërtetën,ai di të zgjedhë fjalë e shprehje të vërteta,t'i shqiptojë qetë ato,të nxisë kërshërinë për të dëgjuar e për të ditur “Ç'ndodh më vonë”;të zgjojë interesim për personazhet.

Paraqitja

Dy të rinjtë që shkrimtari i vë në qendër të vëmendjes(Vita dhe Adili) i paraqet me tiparet më të bukura rinore dhe me virtyte të larta njerëzore.Përshkrimet që shkrimtari i bën portretit të Vitës,qoftë në pamjen e jashtme,apo botën e brendshme të saj,i përmendëm më lart.

Ka shumë tipare që shkrimtari i vesh vajzës së padjallëzuar e cila megjithëse ishte ndonjëherë e ngacmuar nga ndjenjat,gjithnjë ishte e kujdesshme ndaj vrojtimeve lakmuese të gjinisë së kundërt.

Ndërkaq,Adilin shkrimtari na e paraqet si një djalë të ri Kosove,ashtu si në legjendat e lashta,i zhdërvjelltë,me “kokën deri në qiell”,ku qelshja ndan horizontin,me veshjen tipike kosovare të kohës tirq e xhamadan,por ajo që e bën këtë personazh më të afërm e më tërheqës për lexuesin është besa dhe trimëria e tij,pra ai është në gjendje të sakrifikohet për besën e dhënë.

Krahas Adilit,në roman kemi edhe një personazh tjetër i cili në disa raste na del si personazh që dëshiron ta ketë Vitën,por paraqitja e tij nuk është më e ngathtë dhe ai pos që ka dëshirë ta shijojë bukurinë e Vitës nuk tregon ndonjë këmbëngulje më të guximshme për t'ia arritur qëllimit,fjala është për arkeologun fierak,Kozma Ndreken.

Lumi i vdekur ,monumenti gjuhësor i shqipes

Shefkije Islamaj

Në 45 vjetorin,Romani “Lumi i vdekur”i parë në këndvështrimin gjuhësor dhe stilistik

Romani *Lumi i vdekur* mbush dyzet e pesë vjet jetë letrare,ndërsa vazhdon të mbajë vend të çmuar në bibliotekat tona.Qysh nga botimi i tij i parë më 1961,është botuar e ribotuar shumë herë në Shqipëri e Kosovë,është përkthyer në disa gjuhë të huaja,ndërsa nuk ka mbetur pa u vënë re nga dramaturgët dhe rexisorët.Është lexuar e rilexuar shumë nga kritikët e studiuesit,megjithatë jetëgjatësinë e tij në letrat shqipe e ka përcaktuar dhe vazhdon ta përcaktojë lexueshmëria e madhe jashtë këtyre rretheve.Për lexuesin shqipëtar ,Jakov Xoxa mbetet shkrimtar i dashur,i sinçertë,i bindshëm,shkrimtar që ka pasur çka t’i ofrojë lexuesit,ndërsa romani *Lumi i vdekur* mbetet ndër romanet më të realizuar në letërsinë shqipe,ndër romanet më prekës,më dramatik,më lirik dhe më tragjik.

Roman *Lumi i vdekur* i Jakov Xoxës zë vend nderi në pasurinë e kulturës tonë kombëtare,jo vetëm si dëshmi artistike e kohës kur u shkrua,po sidomos si vlerë e qëndrueshme artistike e gjuhësore.Me romani *Lumi i vdekur*,Jakov Xoxa provoi se vepra letrare është gjuhë krijuese,po aq sa është botë krjuese,dëshmoi se gjuha si shprehje e përvojës njerëzore,e pasuruar ndër shekuj e breza,është e gatshme ose mund të përgaditet shpejt për të përcaktuar individualitetin krijues.⁸Me të ai la gjurmë në krijimin e përbashkët gjuhësor të brezave shqipfolës dhe me këtë i siguroi shqipes një prestigj të veçantë duke forcuar bindjen se *gjuha nuk është instrument i dobët dhe fajtor pse nuk shfaqen maja në krijimtarinë letrare,por janë faktorë të tjerë jashtë saj*(Sapir)

Lumi i vdekur është një vepër e madhe epike që trajton në mënyrë të veçantë anë nga më të ndryshme të jetës së shqiptarit brenda viteve 1928-40.Romani shpaloet përmes një ndërtimi mjeshtëror mjetesht të pasura të shprehjes artistike e gjuhësore.Botimi i tij pati jehonë të madhe asokohe,si rrallë ndonjë vepër tjetër letrare,për çka menjëherë u shpall si romani më i suksesshëm në letërsinë shqiptare deri atëherë.

⁸ ShefkijeIslamaj,Gjuha e JakovXoxës,Prishtinë,2000,fq.11

Ai ndikoi fuqishëm në fushën e mendimit kritik,teorik e estetik dhe hapi shtigje për zhvillimin e romanit të ri shqiptar duke bërë thyerje të vërejtshme në traditën e deri atëhershme romanore shqiptare.

Studiues të Xoxës,romanin *Lumi i vdekur* e krahasojnë me veprat kombëtare si *Historia e Skënderbeut dhe Lahuta e Malsisë*,me kryeveprat e traditës evropiane,romanet epike si *Lufta e paqja* e Tolstoit,*Doni i qetë* i Shollohovit,veprën e Todor Drajzerit,apo madje edhe me *Ulisine* e Xhojsit.Ajo që i zgjati jetën romanit *Lumi i vdekur* dhe që do të bëjë të mbetet monument gjuhësor i shqipes,është gjuha dhe stili i tij.Kjo anë e krijimtarisë së tij letrare edhe për studimet gjuhësore shqipëtare do të jetë e një rëndësie të veçantë,sepse paraqet një fazë të zhvillimit të shqipes,në të vërtetë ecurinë e këtij zhvillimi në kohën e pasurimit intensive të saj.

Në përvjetor të veprave të rëndësishme të kulturës shqiptare është bërë si zakon të theksohen vlerat e tyre të vështruara nga anë të ndryshme.Për *Lumin e vdekur* këtë herë duhet të theksohet nga ana gjuhësore e stilistike.⁹Xoxa ka gjuhën dhe stilin e vet që spikatë sidomos në *Lumin e vdekur*.Romani u shkrua në gjuhën standard të kohës të mbështetur fuqishëm në gjuhën e folur popullore.Leksiku,pasuria leksikore dhe semantike,janë anët e veçanta në roman.

Romani *Lumi i vdekur* dëshmon se Jakov Xoxa njihte thellë shqipen në të gjitha rrafshet e shtresat,diti mrekullisht të shfrytëzojë mundësitë krijuese të saj,por edhe mundësitë krijuese të tij. Pati aftësinë të nxjerrë e të ripërtrijë pasurinë gjuhësore të shtresuar në “arkat e fshehta”të shqipes së motive dhe shfrytëzoi burime leksikore e frazeologjike në përmasa të gjera,pasuroi,zgjeroi dhe ripërtri semantikën e shumë njësive leksikore të njohura e te panjohura.

Më konkretisht në fushën e krijimtarisë leksikore,Xoxa solli shumë neologjizma kuptimore e stilistike,fjalë të reja,kuptime të reja dhe ngjyime të pakufishme,ai pasuroi leksikun e shqipes sidomos me njësi njëfjalëshe,pasuroi leksikun poetik:zgjeroi e pasuroi figurshmërinë e shqipes;zgjeroi dhe pasuroi sinoniminë,variantet sinonimike.

⁹ Po aty,fq.45

Plotësoi sistemin leksikor të shqipes së sotme me rikuptimësinë e njësive të ndryshme leksikore;krijoi mjaft terma nga njësi të thesarit popullor:zgjeroi e pasuroi figurshmërinë e disa klasave e grupeve tematike;figurativizoi edhe kategori morfologjike si folje,ndajfolje;bëri rikuptimësimin e figurshëm dhe vlerësues të shumë fjalëve,shumë togëfjalëshave terminologjikë e të mjaft njësive abstrakte,si dhe pasuroi leksikun e veçantë të shqipes me theks të veçantë në atë etnobotanik,etnozoologjik,etnografik etj.

Romani *Lumi i vdekur* shquan edhe për përdorimin e frazeologjizmave.Edhe nga kjo anë mund të thuhet se gjuha e Xoxës është ndër më të pasurat në letërsinë bashkëkohore.Në pikëpamje sasiore është provuar se gjuha e tij tejkalon mesataren 8-10 njësi frazeologjike për faqe.

Romani është plot edhe me mendime të ngjeshura filozofike,të dhëna në formë proverbash popullore,sentencash,aforizmash,e njësish të tjera vendimore.Xoxa ka krijuar edhe një varg përftesash të rëndësishme stilistike.Të tilla janë onomatopetë,pasthirrmat,mallkimet,etj.

Vlen të theksohet se leksiku i *Lumit të vdekur* nuk kufizohet nga pikëpamja kohore a dialektore.Pjesa më e madhe e fjalësit të tij të veçantë është përfshirë në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe(FGJSSH).Vepra e tij letrare përfshin një numër të madh fjalësh:vetëm *Lumi i vdekur* përfshin rreth 12.000 njësi leksikore.

Kjo shifër,nëse vërtetohet si e saktë,dëshmon se gjuha e veprës së Xoxës është ndër më të pasurat në gjithë letërsinë shqipe,sidomos nëse kihet parasysh e dhëna,sipas prof.Lloshit,se numri standard i fjalësit të shumë romaneve tona të njohura sillet prej 5000-7000 fjalë.

Por,Xoxa nuk sjell pasurim sasior vetëm në leksik ,po edhe në semantikën leksikore që,po ashtu me të drejtë,konsiderohet ndër më të pasurat:shkalla e polisemantizmit është jashtëzakonisht e lartë.Së fundmi,në përvjetorin e *Lumit të vdekur* nuk do të duhej t'i mbetnim borxh një shkrimtari të madh siç është Jakov Xoxa.

Kam frikë se i kemi mbetur borxh,ndërsa ai nuk e meriton,sepse në qoftë se shumë çka nga jeta shqiptare e një kohe të caktuar dhe e një ambienti të caktuar,siç ishte Myzeqeja ,në të vërtetë siç ishte Shqipëria e Kosova-e njohim më thellë,në qoftë se shumë çka nga kjo kohë e nga ky ambient-i njohim më mirë,në qoftë se problemet e ditës,problemët e përkohshme dhe ato të përhershme njerëzore e shqiptare të kohës-i ndiejmë më për zemër,duhet t'i jemi mirënjohës sidomos Jakov Xoxës e *Lumit të vdekur*;në qoftë se shumë çka nga pasuria gjuhësore e shqipes së moçme e njohim më thellë,në qoftë se shumë çka nga shqipja e sotme e njohim më mirë,në qoftë se shumë çka nga shqipja e nesërme-e ndiejmë që sot,i jemi sërish borxhlinj,sidomos Jakov Xoxës e *Lumit të vdekur*.

PËRFUNDIMI

Lënda e rëndësishme që shtjellohet tek romani *Lumi i vdekur* dhe gjerësia që përfshin ajo, shfaq me besnikëri gjendjen e shoqërisë shqiptare para Luftës së Dytë Botërore, me tërë antagonizmat klasore e të tjera që kanë egzistuar atëherë. Kjo gjerësi e rrëfimit mundëson shfaqjen e ngjarjeve dhe raporteve që e ndërtojnë jetën si tërësi. Duke i njohur personazhet ngakëndvështime të ndryshme, duke vështuar marrëdhëniet e tyre, botën e brendshme, pikëpamjet mbi jetën e vdekjes, besimin, përpjekjet, ëndrrat, dëshirat dhe çdo gjë që ka të bëjë me jetën dhe të qenit njeri, informohemi mbi vizionet e një periudhe të historisë kombëtare. Në veprën e Xoxës e gjemë botën shqiptare të kohës me të gjitha dritat dhe hijet e saj, ku të diferencuara më shumë e diku të ngatërruara në një masë me njëra-tjetrën.

Xoxa është njohës i mirë i problemeve shoqërore të asaj periudhe por edhe njohës i të gjithë tipave të njerëzve që ka paraqitur në roman. I lindur dhe i rritur në Myzeqë, ai ka jetuar dhe përjetuar situatat për të cilat shkruan; nga kujtimet e bashkëkohësve të tij mësojmë se lënda e krijimeve të tij është jeta reale e myzeqarëve. Duke u inspiruar dhe mbështetur tek realiteti, Xoxa ka arritur ta transponojë atë në nivel të lartë artistik pa anuar asnjëherë nga zhurnalizmi, sepse ai kishte një kujdes të posaçëm në lidhjen e realitetit jetësor dhe atij artistik.

Te *Lumi i vdekur* janë në harmoni të plotë të gjitha elementet e veprës, ndërtimi i personazheve, tema, kompozicioni, roli i narratorit e deri tek ideja themelore. Kohezioni i të gjitha elementeve të përmendura ka rezultuar me paraqitjen e strukturës shoqërore të etapave të caktuara kohore me besnikëri, por edhe nxjerrjen e përvojave të ndryshme që mbeten të tejkohshme. Romani *Lumi i vdekur*, është roman mbi jetën. Triumfi i jetës mbi të gjitha pengesat, si ide e veprës, dëshira për të arritur te niveli më dinjitoz i të jetuarit, materializohet me përpjekjet individuale dhe kolektive që bëjnë fshatarët për të gjallëruar rrjedhën e jetës apo për të ndryshuar kahjen e saj edhe pse e dinë se shpeshherë këto synime kërkojnë flijime të mëdha.

Bibliografia

1. Xoxa,Jakov,*Lumi i vdekur*,1,2,3,NaimFrashëri,Tiranë,1965
2. Xoxa,Jakov,*Lumi i vdekur*,1,2,3,NaimFrashëri,Tiranë,1980
3. Xoxa,Jakov,*Lumi i vdekur*,1,2,3,Rilindja,Prishtinë,1971

Literatura

- 1.Dado,Floresha,*Poetika e veprws letrare*,Tiranë,2003
- 2.Eko,Umberto,*Si bëhet një punim*,Botime Përpjekja,Tiranë,1997
- 3.Grup autorësh,*Letërsia bashkëkohore shqiptare 4*,Libri shkollor,Tiranë,2001
- 4.Islamaj,Shefkije,*Gjuha e Jakov Xoxës*,Instituti albanologjik,Prishtinë,2000.
- 5.*Intervistë me Jakov Xoxën*,Jeta e re 4,Prishtinë,1972
- 6.Vinca,Agim,*Teoritë letrare*,Libri shkollor,Prishtinë,2013
- 7.Welek,Rene&Warren,Austin,*Teoria e letërsisë*,Onufri,Tiranë,2007